

Njoftim i përqendrimit me të cilin Aricoma Grup a.s. nga Republika Çeke do të fitoj kontroll të plotë mbi Consulting 4U s.r.o. nga Republika Çeke

(lënda nr. 08-39 /2023)

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 17.02.2023, në Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të plotë nga Aricoma a.s. me seli në Vinohradska 1511/230, Strashnice, 100 00 Pragë 10 Republika Çeke mbi Consulting 4U s.r.o. me seli në Vellenerova 134/7, Nova Ulice, 779 00 Olomouc, nëpërmjet shitblerjes së 100% të aksioneve në Consulting 4U s.r.o.

- **Grupi Aricoma a.s.** është një kompani holding që menaxhon pjesët në kompanitë bijë të saja dhe fokusohet në zbatimin dhe mbështetjen e aplikacioneve të informacionit të biznesit, mbështetjen e proceseve të biznesit, kujdesin ndaj klientit dhe sigurinë e TI-së. Grupi Aricoma a.s. ofron teknologjitë e sigurisë, vlerësimin e sigurisë, shërbimet e mbrojtjes kibernetike dhe shërbimet këshillimore të GDPR/përputhshmërisë. Grupi Aricoma a.s. i përket Grupit KKCG.

Grupi KKCG investon në fusha të ndryshme biznesi, duke përfshirë lotaritë dhe lojërat e fatit, energjetikë, patundshmëri, industri dhe teknologji të zgjuara dhe është aktive në 33 vende të botës.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi KKCG është i pranishëm në tregun e terminaleve të video lotarisë dhe teknologjisë informatike përmes shoqërive të mëposhtme:

- **Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit KASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MACEDONIJA SHPK Shkup**, me seli në bul. Kiro Gligorov nr.2 Shkup-Gazi Babë dhe me aktivitet prioritar - aktivitetet e lojërave të fatit dhe basteve;

- **Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit Video Lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë-KASINOS AUSTRIA SHPK Shkup**, me seli në bul. Kiro Gligorov nr.2 Shkup-Gazi Babë me aktivitet prioritar - lojërat e fatit dhe basteve;

- **Shoqëria e teknologjisë informatike SEAVUS SHPKNJ Shkup**, me seli në rrugën 1 Tetor nr. 33A/Qendër 1 Shkup dhe me aktivitet prioritar - programim kompjuterik;

- Shoqëria e edukimit Seavus- Qendra për edukim dhe zhvillim SHPKNJ Shkup**, me seli në rrugën 1 Tetor nr. 33A/Qendër 1 Shkup dhe me aktivitet prioritar - arsim tjetër që nuk përmendet diku tjetër dhe

- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime MUSALA SOFT SHPKNJ Shkup**, me seli në rr. Filipi i Dytë i Maqedonisë nr. 3 kati 4/zyra.4003 Shkup dhe me aktivitet prioritar - programim kompjuterik

- **Consulting 4U s.r.o.** është në pronësi të 5 personave fizikë, shtetas çekë dhe nuk ka asnjë filial. Ai fokusohet kryesisht në ofrimin e shërbimeve në fushën e analizës, zbatimit dhe mbështetjes së sistemeve të informacionit për planifikimin dhe menaxhimin e burimeve të biznesit.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

22.02. 2023

Shkup